

KI BESIM



TEK VETJA

FJALA E POPULLIT ËSHTË E PARA

LORIK (10), ERTI (10), JONI (10), FIONA (10), ERA (10), ELSA (10), BORA (10), ANISA (10), TABITA (10),


JONILA (10)

Populli
vendim
marrës



A e dini se në cilin sistem të qeverisjes fjala e popullit është e para dhe ka vlerë të çmuar?

Ne jemi nxënës të klasës së V-të dhe jemi mjaft të mençur dhe kreativ. Ne çdo herë jemi të preokupuar me të ardhmen e shtetit tonë. Kemi fatin që jetojmë në familje të cilat na e kanë sqaruar mirë rolin dhe rëndësinë e qytetarëve. Faktet e sipërpërmendura nuk ndikojnë aspak që ne të jemi më të privilegjuar se pjesa tjetër e shoqërisë.



Demokracia na bashkon të gjithëve

E tërë kjo rrjedh nga barazia dhe të drejtat e barabarta që i gëzon secili qytetar. E nëse dëshironi të dini se në cilin sistem të qeverisjes fjala e popullit është e para dhe ka vlerë të çmuar, ne iu sigurojmë që ky sistem quhet demokraci. Është ky sistemi më i mirë i qeverisjes që simbolizon udhëheqje të përbashkët dhe që promovon sigurinë, lirinë, paqen dhe barazinë për të

gjithë qytetarët e vendeve demokratike. E nëse themi se demokracia ka një zemër, atëherë zemra e demokracisë janë zgjedhjet. Kjo sepse përmes tyre, secilit i jepet e drejta për votë të lirë, secilit i jepet e drejta edhe për të kandiduar, si dhe vota e secilit ka peshë të barabartë.

Ne si 10 vjeçarë nuk e kemi ende mundësinë të votojmë, por e dijmë rëndësinë e saj. Kur të vie koha e paraparë me ligj, unë dhe shokët e mi do ta përmbushim detyrën tonë si qytetarë të Kosovës. Andaj, shfrytëzojmë rastin që t'iu ftojme të gjithëve që sa më parë të vetëdijësoheni edhe ju për rëndësinë dhe vlerën e votës. Demokracia nuk mund të ngritet pa pjesëmarrjen aktive të të gjithëve. Kaq të vegjël jemi, por shumë të interesuar që ta zhvillojmë demokracinë e vendit. E ju që jeni edhe një hap më përpara se ne dhe mund të votoni, dilni dhe votoni me mençuri. Ju mundeni dhe ne do t'iu bashkangjitemi pas pak vitesh!



Demokratët e vegjël dhe simpatikë

LIGJET, RREGULLUESIT E JETËS

LISA (10), ALBIONA (10), ERONA (11), FIONA (10), EDONA (10), MILOT (10), ARON (10), DAUT (11),
ENDI (10), BAMIR (11)



Të drejtat e barabarta i gëzojmë pa dallime gjinie



E drejta jonë të shprehemi lirshëm është e rëndësishme

Po e shkruajmë këtë artikull me shumë përkushtim për ju të dashur lexues. Shpresojmë që puna jonë do t'ju pëlqej

Ishte periudhë me ditë të vështira për Kosovën. Pas okupimit serb, qytetarët e Kosovës nuk ishin të lirë dhe të pavarur siç janë sot. Ata nuk kishin mundësi të shpreheshin dhe të vepronin lirshëm. Fjala e tyre nuk ishte e rëndësishme dhe në vendin tonë nuk kishte aspak demokraci.

Mirëpo, tash çdo gjë është ndryshe, pasi që Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe demokratik. Tani qytetarët tanë mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre dhe të veprojnë të lirë. Të gjithë ne i kemi të drejtat e barabarta pa dallim gjinie, feje, moshe, race, etj. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj, të cilat miratohen në „Shtëpinë e Popullit“, në Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi është një institucion shumë i rëndësishëm për të gjithë qytetarët. Aty merren vendime që ndikojnë në jetën e secilit. Po ashtu, Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë. Deputetët të cilët punojnë aty, përfaqësojnë popullin, sepse ata janë zgjedhur me vota të lira nga populli.

Po të pyeste dikush pse duhet të jetë populli i kujdesshëm gjatë zgjedhjes së deputetëve, ne do të përgjigjeshim: „populli duhet të jetë i kujdesshëm kur i zgjedh deputetët, sepse nëse votohet kandidati i gabuar dëmtohen vet ata. Ndërsa, nëse votohet kandidati i

përshtatshëm dhe i denjë për pozitën e deputetit/es, vendi do të ketë një zhvillim dhe të ardhme të ndritur.“ Sikurse lulet që lulëzojnë në pranverë, edhe shteti lulëzon nëse ne veprojmë dhe punojmë duke qenë qytetarë të përgjegjshëm.



Drejtësi dhe barazi, vetëm në demokraci



Grupi „Drejtësia“




Elementi bazë i sistemit demokratik është liria




Në bazë të sistemit demokratik, jetojmë në harmoni



Ne shprehim mendimet tona lirshëm



Dhe kur të vijë koha për të votuar, ne do të votojmë




Këtë të drejtë nuk mund të na e marrë askush



Si dhe, marrim njohuri vazhdimisht dhe kudo që shkojmë

PËRGJEGJËSITË E TË DREJTAT TONA

DREN (10), ERZA (11), MELOS (10), ADEA (10), ERJONA (10), ELSA (10), LIRJON (11), LEONARD (10),
ERBLIN (10), LORINA (10)



Të bëhemi qytetarë aktiv për të mirën e vendit tonë dhe të gjithë neve

Në lagjen tonë kemi pasur një problem, i cili na ka shqetësuar të gjithëve. Rruga e lagjes ishte dëmtuar shumë. Ne si qytetarë e ndjemë nevojën të bënim diçka për të gjetur një zgjidhje. Sigurisht se Komuna



e Prishtinës nuk do të ishte e njoftuar për problemin tonë, nëse ne nuk do të bënim diçka për t'iu treguar zyrtarëve të saj. Ka disa probleme që ne vetë si qytetarë mund t'i rregullojmë, kurse disa të tjera nuk mundemi. Rasti ynë ishte i tillë që ne nuk mund ta zgjidhim vetë këtë problem, pa ndihmën e Komunës sonë.

Kështu, një ditë, u organizuam dhe krijuam një peticion, si dhe mbledhëm nënshkrimet e të gjithë banorëve të lagjes. Atë peticion e dërguam në Komunën e Prishtinës. Pas një kohe të shkurtër, rruga jonë ishte

rregulluar dhe të gjithë ishim shumë të lumtur. Pra, ne u aktivizuam për lagjen tonë.

Nënshkrimi i peticionit është vetëm njëra nga mënyrat se si ne mund të jemi aktiv për vendin tonë. Gjithçka që ne bëjmë për të mirën e komunitetit dhe qytetarëve të tjerë quhet aktivizëm. Këtu hyjnë: pjesëmarrja në zgjedhje, tubimet e protestat paqësore, angazhimi në OJQ apo shoqata të ndryshme, puna vullnetare, etj. Ne si qytetarë kemi edhe përgjegjësi ndaj vendit tonë. Numërojmë: përgjegjësia për të votuar, për të ruajtur pronat publike, për të respektuar ligjin, etj. Qytetarët janë shtylla më e fortë e demokracisë. Demokracia nuk mund të ekzistoj pa ne. Andaj, kërkohet angazhimi i të gjithë neve. Kjo është e mirë reciproke, sepse ne i respektojmë elementet e demokracisë dhe jemi aktiv për vendin tonë. Ndërkaq, demokracia na siguron të drejta dhe një jetë plot me lumturi.



Ne, autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë